

PROFILI TURISTIK I KOMUNËS SË SHTIMES

Në territorin e komunës së Shtimes nuk ka ndonjë objekt apo zonë turistike me infrastrukturë përcjellëse ku qytetarët e Shtimes do të mund të kalonin pushimet dhe vikendet. Me fjalë të tjera në Shtime aktualisht nuk ka ofertë turistike, por qytetarët Shtimjan ofrojnë ne pjese te caktuara te territorit te Shtimes oferta individuale dhe po ashtu bëjnë turizëm në zonat e tjera turistike, si Blinaja(gjueti), Brezovicë (skijim, etj), Prevala (shëndetësorë) dhe qendrat apo zonat e tjera që ndodhen në Kosovë.

Objektet që ofrojnë qëndrim dhe akomodim 24 orë kanë në dispozicion 70 dhoma me numër të shtretërve 80. Numri i vizitorëve për një muaj është 350. Në këto objekte përfshihen motele, restaurantet dhe pishinat:

- Motel "TIRANA" në fshatin Carralevë
- Restaurant "TITANIC" & Motel në fshatin Davidovc
- Restaurant "TROFTA" në fshatin Petrovë
- Motel "GRANITI" & Pishina në fshatin Belinc
- Restorant "GLOBUS" në kilometrin e tretë të magjistrales Shtime - Ferizaj
- Restaurant "VILLA PLUS" & Motel në fshatin Dugë
- Motel "MENTORI AG" në fshatin Davidovc
- Motel & Restaurant "RELAX" në fshatin Davidovc
- Motel "VILLA ART" Në Rrugën "Komandant Kumanova" - Shtime
- Restaurant "KRONI" & Motel në fshatin Pjetërshticë
- Restaurant "AQU-PARK" & Pishina në fshatin Davidovc
- Restaurant "LIDO" & Pishinë në fshatin Davidovc
- Pishina "CREJZI" në Lagjen e Pajtimit



Restaurant & motel "Villa Plus" në fshatin Dugë



Restaurant "Trofta" në fshatin Petrovë

► Atraksionet turistike natyrore




Pamje atraktive nga "Gryka e Llanishtit"

- Në mesin që ndan fshatrat Carralevë dhe Belinc rritet një lloj i veçantë i lules i cili quhet: "Lule Bozhur", po ashtu në këto dy fshatra rritet dhe kultivohet "Çaji i Malit"

- Është në rrugë e sipër projekti për rregullimin e hapësirave publike, përkatësisht Parku te Qendra Rinore në Shtime. Ky projekt financohet me 48,000€ nga Qeveria Zvicerane, i cili do të zbatohet nga Helvetas Swiss

Intercooperation e Fondacioni Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim, kurse Komuna e Shtimes do të participon me 30%.

► **Parqet, shëtitore dhe zona rekreative**



Zonë e rekreative në qytetin e Shtimes me sipërfaqe prej 15ha dhe sheshet ne qytetin e Shtimes